


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



| PERIUDHA | 1M | 3M | 1V | 3V | 5V | NGA THEMELIMI |
|------------|--------|--------|--------|---------|---------|----------------|
| REZULTATI | -0.56% | +0.53% | +5.82% | +14.17% | +33.85% | +42.63% |
| BENÇMARKU* | +0.30% | -0.78% | +1.91% | +1.18% | +4.30% | +33.06% |

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM2 2017

ÇMIMI I AKSIONIT:

| | |
|---------------------------|-----------------|
| PRILL | ▲ +0.44% |
| MAJ | ▲ +0.66% |
| QERSHOR | ▼ -0.56% |
| GJITHSEJ PERFORMANCA NETO | ▲ +0.53% |

KTHIMI BRUTO:

| | |
|-----------------------|-------------|
| PRILL | +€7.14 mln |
| MAJ | +€10.57 mln |
| QERSHOR | -€8.16 mln |
| GJITHSEJ KTHIMI BRUTO | +€9.55 mln |

KRYESORET

| | | | |
|-------------------------------------|-----------|-------------------------------------|----------------|
| ÇMIMI I AKSIONIT NË FUND TREMUJORI | €1.4263 | MJETET NETO NËN MENAXHIM | €1,533,736,117 |
| PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR | €8.18 mln | PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT | €14.84 mln |
| TË PENSIONUARË PËR PERIUDHËN | 1,513 | TË PENSIONUARË PËR VITIN | 2,834 |
| LLOGARI TË KONTRIBUESVE | 556,490 | LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUDHËS | 286,793 |
| KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT | 14,632 | KONTRIBUTE TË REJA KËTË VIT | €77.00 mln |
| SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT | 45,124 | GJITHSEJ LLOGARI NË TRUSTI | 73,501 |

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES / EMETUES NË TM2 2017

| MENAXHUESI/EMETUESI | EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS | PLASMANET | PJESËMARRJA | PERFORMANCA | KONTRIBUIMI NË PERFORMANCËN BRUTO TË FKPK |
|-------------------------------------|---------------------------------------|------------------------|---------------|---------------|---|
| Vanguard | Global Stock Index Fund - Euro | €312,890,306 | 20.40% | +2.31% | +0.63% |
| Nordea | 1-Stable Return Fund | €240,634,752 | 15.69% | +0.38% | +0.06% |
| Nordea | 1-Global Stable Equity Fund | €173,319,929 | 11.30% | -2.56% | -0.30% |
| BNY Mellon | Global Real Return Fund | €142,963,326 | 9.32% | +1.04% | +0.10% |
| AXA | Global Inflation Linked Bonds | €98,844,021 | 6.44% | -1.01% | -0.07% |
| Thesari i Republikës së Kosovës | Obligacione dhe fletobligacione | €68,804,341 | 4.49% | +0.41%* | +0.01% |
| AXA | WF Optimal Income I EUR | €64,745,078 | 4.22% | +2.00% | +0.11% |
| Pictet | High dividend selection Z EUR | €59,965,369 | 3.91% | -2.28% | -0.09% |
| Schroders | ISF Global Diversified Growth | €74,860,360 | 4.88% | +1.05% | +0.05% |
| Amundi | Rendement Plus Part I2 | €51,513,228 | 3.36% | +1.00% | +0.04% |
| BNP Parvest | Diversified Dynamic | €74,199,094 | 4.84% | +1.39% | +0.07% |
| Schroders | Strategic Bond - Euro Hedged | €10,355,962 | 0.68% | +0.84% | +0.02% |
| Banka Kombëtare Tregtare | Depozitë me afat | €8,062,594 | 0.53% | +0.36%* | +0.00% |
| Banka për Biznes SH.A. | Depozitë me afat | €8,078,115 | 0.53% | +0.44%* | +0.00% |
| TEB SH.A. | Depozitë me afat | €4,021,147 | 0.26% | +0.25%* | +0.00% |
| GJITHSEJ MJETE TË INVESTUARA | | € 1,393,257,622 | 90.85% | +0.53% | 0.63% |

*Performanca e bazuar në norma fikse të interesit.

€9.55 MLN KTHIMI BRUTO PËR TM2 2017

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e përmbylli edhe tremujorin e dytë 2017 me kthim pozitiv nga investimet prej €9.55 mln ose me një rritje prej 0.53% e çmimit të njësisë. Bashkë me kthimin nga TM1, gjysma e parë e vitit përfundon kështu me një kthim bruto prej €56.25 mln. Në TM2 mjetet nën menaxhim u rritën për 38.91 mln dhe arritën në 1,533.74 mln. Në rritjen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kthimi nga investimet (€9.3 mln) dhe kontributet e reja (€39.35 mln). Ndërkohë për të njëjtën periudhë: për pension u shpagueu €8.18 mln, për tarifa menaxhuese €1.80 mln dhe u refunduan 5,768 euro.

FAKTORËT ME NDIKIM

Ky ishte një tremujor me një rritje të kënaqshme për tregun global të aksioneve, me indeksin e MSCI që u rrit për 4.2% në terma të dollarit amerikan. Shtysë e këtij progresi në tregun e aksioneve ishin të ardhurat inkurajuese të korporatave por edhe avancimi i treguesve të zhvillimit ekonomik në SHBA, BE, Mbretëri e Bashkuar dhe Japoni. Ndihe në këtë aspekt kishte edhe rënia e riskut politik në Evropë, ndërsa ndikim negativ pati pasiguria e implementimit të lehtësirave fiskale në SHBA. Megjithatë nuk kishin të njëjtin ritëm instrumentet e kthimit absolut, më saktë tregu i bonove shtetërore. Përkundër rritjes së qëndrueshme gjatë shumicës së periudhës, pasiguritë e politikave monetare në SHBA, Eurozonë dhe MB çuan në shitje të shpejtë të pozicioneve në fund të qershorit. Kjo ndikoi në uljen e interesave/kthimeve nga ky instrument për gjithë treumujorin e dytë.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Nga 11 fondet e angazhuara këtë periudhë 8 prej tyre kishin performancë pozitive. Performancën më të mirë e kishte fondi i Vanguard GSEF (+2.31), një fond i pastër në aksioneve dhe me dominim të investimeve në SHBA. Ky fond, për shkak edhe të mjeteve që FKPK-ja i ka të investuara, ishte dukshëm kontribuuesi më i rëndësishëm i performancës pozitive të fondit të FKPK-së për këtë periudhë. Jo larg ishte edhe fondi AXA WFOI (+2.00%), një fond ky i përzier investues (me rreth 70% në aksione) dhe me përqendrim të fortë të investimeve në Eurozonë. Ndërsa fondi i BNP Parvest (me +1.39%) ishte i treti, duke pasur një portofol investues të diversifikuar fort, si në instrumente financiare ashtu edhe në shpërndarjen gjeografike. Fondet e tjera me performancë pozitive ishin në nivele modeste të rritjes prej +0.38% e 1.05%.

Nga tri fondet me performancë negative, më së dobëti performuan dy fondet në aksione: Nordea GSEF (-2.56%) dhe Pictet HDS (-2.28%). Këto dy fonde duke se kishin këtë rezultat nga përzgjedhja individuale e investimeve të tyre dhe jo nga instrumenti investues ose shpërndarja gjeografike. Ndërsa fondi në bono globale i AXA GILB (me -1.01%) është drejtpërdrejt i lidhur me nivelin e inflacionit global dhe kjo periudhë nuk është ishte përfituese për të. Nga fondet me performancë negative, për shkak të mjeteve të FKPK-së që menaxhon, fondi i Nordea GSEF ndikoi dukshëm më së shumti negativisht në kthimin nga investimet e FKPK-së.

Nga ana tjetër, investimet në Kosovë (në obligacione dhe fletobligacione të Qeverisë dhe në depozita bankare) ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe kontribuan mesatarisht në performancën e përgjithshme me 4.85% të të gjithë performancës së FKPK-së për këtë periudhë.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM2

+0.53%

KRYESORET E TREMUJORIT

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E DYTË PËR 2017

Bordi Drejtues, në mbledhjen e mbajtur në qershor 2017, pasi ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe bazuar në rekomandimet e Komisionit të Investimeve, ka marrë këto vendime: 1) të ndryshohen targetet për matricën e Alokimit Strategjik (5% celula e keshit dhe -5% kutia e aksioneve drejtimore); 2) të tërhiqen €75 mln nga fondi i Vanguard; 3) të tërhiqen €12 mln nga fondi i AXA-OI; 4) të angazhohet fondi i tregut të parasë së gatshme i Amundi 3M-I dhe investimi i parë aty të jetë €20 mln; 5) të konkurrohet në bonot 2-vjeçare të Kosovës për €10 mln.

U SHPËRNDANË PASQYRAT VJETORE

Posta e Kosovës, e kontraktuar nga FKPK (siç obliogohet me ligj), e ka përfunduar në maj shpërndarjen e pasqyrave vjetore për vitin 2016. Për shpërndarje me postë këtë vit janë dërguar 290 mijë pasqyra, ndërsa në formë elektronike nuk janë përfshirë rreth 107 mijë pasqyra që nuk kishin transaksione në llogarinë e kursimit në tri vjetët e fundit. Dhe kjo nuk është 100% e saktë - meqë nëse kemi pasur email për ta iu kemi dërguar pasqyren ani pse s'kanë pasur transaksione në 3 vjetët e fundit. Njëjtë vlen edhe me ata 16 mijë për të cilët nuk kemi adrese valide.

RRITET ARKËTIMI I KONTRIBUTEVE TË REJA

Vlera e kontributeve të reja në gjysmën e parë të 2017-s është rritur për 3.91% më shumë krahasuar me në të njëjtën periudhë të një viti më parë (përkatesisht nga €74.1 mln në €77.0 mln). Kjo rritje duke se erdhi nga shtimi i vlerës së kontribuimit dhe jo nga rritja e të hyrave të kontribuuesve, pasi numri i kontribuuesve të rinj ka qëndruar gati i njëjtë (nga 14,779 kontribuues të rinj gjysmëvitin e shkuar në 14,632 sivjet).

€8.18 MLN PENSIONE NË TM2

Vlera e pensioneve të shpaguara këtë tremujor arriti në total €8.18 mln, ndërkohë që numri i llogarive të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet numëruan 1,513. Shuma e tërheqjeve është më e lartë sesa më TM1 2017 kur ishin shpërndarë €6.66 mln për 1,321 përfitues. Në total për gjysmëvitin e parë 2017 janë shpërndarë €14.84 mln ndërsa janë pensionuar rishtazi 2,834 llogari.

PUBLIKOHET RAPORTI VJETOR PËR 2016

FKPK-ja e ka publikuar Raportin Vjetor për vitin 2016 në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Raporti vjetor është publikimi më i rëndësishëm i institucionit dhe përmbledh të dhënave dhe ngjarjet më të rëndësishme të vitit. Raportet vjetore mund të gjenden online në vegzën vijuese: <http://trusti.org/sq/per-ne/reports-alb/raportet-vjetore>

MBI 73 MIJË LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM2 2017 arriti në 73,501 ose një rritje prej rreth 6% për këtë tremujor. FKPK-ja edhe këtë tremujor e promovoi këtë shërbim përmes rrjetit social Facebook. Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Korrik 2017

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

info@trusti.org
www.trusti.org